



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 754 / prot.

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr. 47, datë 20.03.2025

Për

**miratimin e tarifës së përgjithshme të shkollimit në programet e studimit edhe në gjuhën Angleze në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, shkronja b, neni 35, pika 1, neni 38 pika 1, germa "dh", neni 49, pika 1, në Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen dhe bashkimin e IAL", Kreu IV, germa A, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Vendimeve të të Senatit Akademik për hapjen e programeve të studimit në gjuhë të huaj në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Tarifa e përgjithshme që do të paguajnë studentët e huaj në programet e studimit në gjuhën Angleze do të jetë 2,500 euro në vitin akademik, e cila do të derdhet në Degën e Thesarit për Universitetin. Tarifa e përgjithshme, përfshin tarifën e shkollimit për shërbimin mësimor në Universitet dhe tarifën e shërbimit nga subjektet ndërkombëtare për konsulencën dhe rekrutimin e studentëve të huaj në programet e studimit në gjuhën Angleze.
2. Të lidhet marrëveshje me subjektet ndërkombëtare të konsulencës dhe rekrutimit të studentëve të huaj, duke përcaktuar format dhe rregullat për regjistrimin e studentëve dhe pjesën takuese të secilit në tarifën e përgjithshme. Pjesa takuese subjektit ndërkombëtar do t'i transferohet në përfundim të procesit të regjistrimit, pasi të jenë kryer pagesat nga të gjithë studentët e regjistruar prej saj.
3. Studentët e programeve të studimit në gjuhë të huaj e paguajnë tarifën e përgjithshme të shkollimit në momentin e regjistrimit në vitin akademik përkatës.
4. Vendimi i Senatit Akademik i dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për procedurat e mëtejshme të miratimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I SENATIT  
Prof. Dr. Elvira Fetahu